



VENDIM

Nr.60 Datë 23.04.2015

PËR

FILLIMIN E PROÇEDURAVE PËR LIÇENSIMIN E SHOQËRISË “PËRPARIMI SK” SH.P.K., NË AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC “SHTIKA”.

Në mbështetje të neneve 8 pika 2 gërma “a”; 9 dhe 13 pika 1, gërma “a”, të Ligjit nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, neneve 4, pika 1, gërma “a”; 5 pika 1 gërma “a”; 13 dhe 14 pika 1 të “Rregullores për Proçedurat e Liçensimit, Modifikimit, Transferimit të Plotë/Pjesshëm dhe Rinovimit të Liçensave”, të miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve Nr. 108, datë 09.09.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 23.04.2015, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria **“PËRPARIMI SK”**sh.p.k, sidhe relacionin e Drejtorisë së Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për liçensimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie, me fuqi totale 1.3 MW.

Konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë **“PËRPARIMI SK”** sh.p.k, plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat e liçensimit, modifikimit, transferimit të plotë/ të pjesshëm dhe rinovimit të liçensave”, si më poshtë:

Neni 9, pika 1, Format i aplikimit është plotësuar në mënyre korrekte

Neni 9, pika 2 Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor është plotësuar në mënyre korrekte .

Neni 9, pika 3 Dokumentacioni financiar dhe fiskal është plotësuar në mënyre korrekte .

Neni 9, pika 4.1.1 Të dhëna specifike për HEC është plotësuar në mënyrë korrekte.

Neni 9, pika 4.1.2 Të dhëna për bllokun e transformimit dhe lidhjen me sistemin është plotësuar në mënyrë korrekte.

Neni 9, pika 4.1.3 Dokumentacioni teknik dhe grafik është plotësuar në mënyrë korrekte .

Neni 9, pika 4.1.4 Dokumëntacioni tekniko- ekonomik është plotësuar në mënyrë korrekte

Neni 9, pika 4.1.5 Leje nga institucione të tjera është plotësuar tërësisht.

Për gjitha sa më sipër Bordi i Komisionerëve të ERE-s,

Vendosi:

1. Fillimin e procedurave për licensimin e shoqërisë **“PËRPARIMI SK”** sh.p.k., nëaktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga Hec **“SHTIKA”** me fuqi totale 1.3 MW.
2. Ngarkohet Drejtoria e Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI i ERE-s

Petrit AHMETI